

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

18.03.2021
Ora 11:12

RENDI I DITËS


Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Aleanca Liberale e Djathtë”, (ALD), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja, Znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike:** **PD (I. Sefa) (F.Nuri) PL (A. Kaziaj)**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirëmëngjesi të gjithëve! Atëherë, fillojmë seancën publike për shqyrtimin e këtyre çështjeve. Kërkesa e koalicionit “Aleanca Liberale e Djathtë” për tu regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e 14 majit 2023. Për shqyrtimin e kërkesës së koalicionit “Bashkë Fitojmë”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për këto zgjedhje. Kemi në rend të ditës çështjen që ka të bëjë me zbatimin e vendimit nr.27, datë 16.03.2023, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Pika e katërt ka të bëjë me shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues, zotin Rodolf Llambi Xhillari, anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë. Pika e fundit ka të bëjë me një ndryshim në vendimin nr.100, datë 08.03.2023, për caktimin e numrit të kandidatëve në listat shumemerore të paraqitura nga subjektet zgjedhore për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. Mirë atëherë, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së

**Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

Koalicionit “Aleanca Liberale e Djathtë” për tu regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e 14 majit 2023. Fjala për sekretarin e KQZ-së.

Z. Y. Merkaj: Po, faleminderit! Tre parti politike, Partia Balli Kombëtar, Bashkimi Liberal Demokrat dhe partia Bashkimi Demokrat Shqiptar kanë paraqitur kërkesë përpara KQZ-së për tu regjistruar si koalicion me emrin “Aleanca Liberale e Djathtë”. Këto parti politike janë regjistruar si subjekte zgjedhore në KQZ. Bashkëlidhur me kërkesën kanë paraqitur marrëveshjen, emrin e koalicionit, shkronjat nistore, partinë politike udhëheqëse të koalicionit si edhe personin e autorizuar që do i përfaqësojë dhe zëvendësin e tij. Bashkëlidhur keni projektvednimin për shqyrtim e miratim, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, përfaqësues të partive? Diskutim për këtë?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po Komisioner, Indrit Sefa, përfaqësues i Partisë Demokratike të Shqipërisë. Së pari doja të kërkoja një kopje të dokumentacionit dukë qenë se kemi interes të ligjshëm në lidhje me paraqitjen e këtij kërkimi dhe doja të konfirmoja dokumentacionin e paraqitur si dhe të bëj një interpretim lidhur me dispozitën ligjore që përcakton bërjen e këtyre koalicioneve dhe menyren e.... kur duhet deputetët të delaroheshin si përfaqësues të këtyre partive.

Z. I. Celibashi: Ndërkohë që zoti sefa konsultohet me dokumentacionin, përfaqësuesit e partive të tjera?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL-së: Po zoti Celibashi, faleminderit për fjalën! Ndërkohë që që zoti Sefa e ka si praktikë historinë e check and balance, duke

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

përdorur edhe terminologjinë e interesit të ligjshëm të cilin nuk e ka. Ndërkohë edhe seancat e shkuara, ndërkohë që kemi rend dite për shqyrtim sipas njoftimit të bërë nga ana juaj. Pikën e parë për shqyrtimin e kërkesës së Koalicionit "Aleanca Librale e Djathtë". Mendoj se duhet të ishin përfaqësuesit e këtij koalicioni. Nëqoftëse do të kishit ndonjë kundërshti ose ndonjë sqarim lidhur me institucionin tuaj, për të vënë në lëvizje dhe për të dhënë argumentet e tyre. Kështu që mos të vonojmë kot seancën, me histori të legjitimitetit aktiv ose pasiv, të një subjekti që ende nuk është regjistruar pranë jush dhe të vazhdojmë atë që është rendi i ditës. Falminderit!

Z. I. Celibashi: Thjesht për sqarim përpara se ti jap fjalën zotit Sefa. Në KQZ pavarësisht interesit për çështje të caktuara drejt për së drejti ose jo, subjekte të caktuara politike kanë si përfaqësues të partive politike në KQZ, mendoj dhe jo vetëm se kështu ka qenë tradita, që kanë të drejtën të japin mendime dhe opinione për çështjet, tej faktit nëse ka legjitimitetin për të pretenduar për themelin. Kështu që...

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL-së: Jam shumë dakord me juve sepse ky është një qendrim dhe një praktikë e vendosur nga ana juaj, me një transparencë që i bën nder këtij institucioni. Fakti është që, kur flitet për... dhe ju vet e cituat në atë që thatë, si përfaqësues të partive politike. Ndërkohë që unë Altin Kaziaj jam përfaqësues i një partie politike të regjistruar dhe të një koalicioni që do të regjistrohet ditën e sotme, të paktën sipas rendit të ditës. Ndërkohë kolegu në krahun tim nuk e di se përfaqësues i cilës parti është dhe a është regjistruar kjo parti, për të marrë legjitimitetin për tu shprehur në emër dhe në interes të ligjshëm lidhur me rendin e ditës, falemnderit.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

Z. I. Celibashi: Faleminderit, po zoti Sefa!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Besoj se kolegu ka qenë shumë i zënë për të parë se në lajmet dhe publikimet e KQZ-së ka një vendim nr. 27, dt. 16.03.2023, por dy ditë kolegu do të ketë qenë i zënë për të mbrojtur edhe praktikën e koalicionit pranë Komisionerit i cili ka deklaruar dhe është shprehur në disa raste që e zbaton ligjin në gërmë dhe ndaj edhe kolegu përpara se të ngrinte këto pretendime, e mira është që të informohet. Gjithsesi, duke qenë se jemi në një fushatë zgjedhore dhe Partia Demokratike e Shqipërisë është regjistruar, ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar nga KAS-i , për të pasë një garë të drejtë ...

Z. I. Celibashi: Më fal, jemi tek pika e parë që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës...

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Aty do të dal direkt, menjëherë.

Z. I. Celibashi: Dakord!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Unë do të doja ti referoresha nenit 68, pika 3 Komisioner, i cili thotë, “Për qëllime të këtij neni, partia politike paraqet një kërkesë me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muaj përpara përfundimit të mandatit të kuvendit ose organit të njësisë së qeverisjes vendore. Në bazë dhe të deklarimit të zotëruesve të mandateve për përkatësinë politike në institucionin përkatës. Kemi 3 deputetë të cilët janë vetëdeklaruar. Zoti Luan Baçi është

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

deklaruar në datën 13 mars, zoti Edmond Spaho në datën 15 mars dhe zoti Dritan Shehu, në mos gaboj, në datën 15 mars. Zoti Luan Baçi është deklaruar si deputet i partisë Balli Kombëtar Demokrat, domethënë është vetëdeklaruar në datën 13 si deputet i partisë Balli Kombëtar Demokrat. Zoti Edmond Spaho është deklaruar si deputet i Bashkimit Demokrat në datën 15 dhe zoti Dritan Shehu është deklaruar si deputet i Bashkimit Liberal Demokrat në datën 15.03 2023. Dokumentet janë në praktikën që ka KQZ-ja. Është fare e qartë zoti Komisioner që këto deklarime duheshin bërë përpara datës 27.01.2023. Po marr certifikimin e zgjedhjeve vendore të vitit 2019 ku Komisioneri ka nxjerrë rezultatin përfundimtar të këtyre zgjedhjeve në datën 27 korrik 2019 dhe në bazë të dispozitës këta deputetë nuk legjitimohen për të bërë një kërkim të tillë. Këto subjekte për qëllim të paraqitjes së listave dhe kandidatëve në zgjedhjet vendore të 14 majit 2023 duhet të mbështeten nga 1% e zgjedhëzve. Në rastin konkret kanë gjetur formulën të kenë mbështetjen e 3 deputetëve, të cilët janë deklaruar së fundmi. Dispozita është fare e qartë dhe nuk mund të lejohet që këta 6 muaj përpara mbarimit të mandatit të organeve të qeverisjes vendore të bëhet një deklaram i tillë dhe të pranohet nga ana e Komisionerit. Ndaj mendoj se ky propozim nuk është në zbatim të ligjit dhe të dispozitës ligjore dhe rrjedhimisht Komisioneri duhet ta refuzojë këtë kërkesë dhe mos ta marrë në konsideratë. Dispozita ligjore është fare e qartë, ndaj dhe qendrimi jonë është që Komisioneri duhet ta rrëzojë këtë kërkesë, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Po faleminderit! Pra ju po thoni që kërkesa për regjistrimin e këtij kolicioni nuk duhet të pranohet sepse të deklaruarit si deputet të partive përbërëse të koalicionit, këtë deklaram nuk e kanë në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor. Për këtë arsye?

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po ta shikoni, kjo dispozitë është ndryshuar në vitin 2023, më falni në vitin 2020, me ndryshimet kushtetuese të datës 5 tetor të vitit 2020 dhe ka qenë qëllimisht e ndryshuar për të mos lejuar trafikimin e deputetëve në subjekte të tjera në momentin që bëhet regjistrimi. Po të shikoni se si ka qenë dispozita. Ka qenë shumë e vakët edhe thuhet “Të jenë deputet 6 muajt e fundit”. Është ndryshuar dispozita dhe është shtuar i gjithë paragrafi në pikën 3. Po të shikoni ligjin nr. 118, të vitit 2020, data 05 tetor 2020 që janë dhe ndryshime të Kodit Zgjedhor , në nenin 8 të tij është fare e qartë se kjo dispozitë është ndryshuar me qëllim për mos lejuar këtë trafikim deputetësh, për të bërë të mundur regjistrimin e subjekteve, duke marrë hua deputetë nga subjekte të tjera. Kjo ka qenë një praktikë e ndjekur nga subjekte në shumë vite, gjatë gjithë funksionit të KQZ-së, prandaj legjislatori e ka parë të arsyeshme që të ndryshojë këtë dispozitë dhe të bëjë këtë ndryshim në Kodin Zgjedhor. Me qëllimin e vetëm që të mos lejojë ndryshimin e deputetëve, vetëm për efekte zgjedhore. Kjo ka qenë edhe logjika dhe fryma e legjislatorit në momentet e ndryshimit të ligjit.

Z. I. Celibashi: Po zoti Kaziaj dhe shpresoj të jetë e fundit.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL-së: Po dhe unë shpresoj të jetë e fundit sepse po i bëjmë Kodit Zgjedhor dhe pikërisht nenit 68, pika 3, togfjalëshit ku ligjvënësi në mënyrë shumë të qartë del kolegu në mënyrë shumë ...*(nuk kuptohet)*, e interpreton sipas një interesi thjeshtësisht të ngushtë të tij. Thotë “Ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muaj përpara përfundimit të mandatit të kuvendit ose të organit të njësisë së qeverisjes vendore. Pra nuk është një limit 6 mujori, është limit që të paktën nga 6 mujori e deri në datën e vetëdeklarimit të bëhet një vetëdeklarim dhe një vërtetim nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit që

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

x deputet është përfaqësues i x partie. Është shumë e thjeshtë fryma e ligjvënësit, Tani me këto tregimet që bëri parafolësi, kolegu im, vetëm sa na zgjat atë që është, të themi, koha për të cilën realisht duhet të kemi këtë seancë duke bërë gjëra të natyrës së procedurës dhe na largon nga thelbi i një gjëje që është shqyrtuar nga ana juaj më shumë se një here. Janë marrë vendime më shumë se njëherë, nuk janë ankimuar asnjëherë, nëpërmjet të cilave ju keni dhënë atë që ka qenë në vetvete fryma e ligjvënësit. Ky është interpretimi që i duhet bërë dispozitës. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, besoj se nuk ka vend për diskutime të tjera nga përfaqësuesit e partive politike. Atëherë në lidhje me këtë kërkesë të paraqitur nga ky koalicion i këtyre partive mendoj se ajo kërkesë është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor. Pretendimet që ngriti kolegu Sefa janë pretendime që i takojnë një shqyrtimi tjetër, në momentin kur do të paraqiten listat shumemërore. Edhe dispozita që juve ju referuat, neni 68 i Kodit Zgjedhor, flet pikërisht për kushtet që duhet të plotësohen në momentin që paraqitet lista shumemërore. Në momentin që paraqitet kërkesa për regjistrimin e një koalicioni, e vetmja dispozitë që e rregullon këtë është neni 65 i Kodit Zgjedhor dhe sipas nenit 65 të Kodit Zgjedhor dy ose më shumë parti politike të regjistruara në KQZ, sipas nenit 64 të këtij kodi, mund të regjistrohen në KQZ si koalicion. Pra i vetmi kusht që kërkon Kodi Zgjedhor për regjistrimin e një koalicioni, është që partitë që kërkojnë të jenë pjesë e koalicionit, të jenë regjistruar në KQZ. Meqenëse partitë politike, Balli Kombëtar Demokrat, Bashkimi Liberal Demokrat dhe Bashkimi Demokrat Shqiptar janë të regjistruara si subjekte zgjedhore, kanë gjithë të drejtën, bazuar në vullnetin e tyre politik që të paraqesin kërkesën për tu regjistruar si koalicion dhe nga vlerësimi që i bëj dokumentacionit rezulton që kjo kërkesë është

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor, por edhe me dokumentacionin që ka shoqëruar kërkesën e tyre. Vendos:

1. Regjistrimin e Koalicionit “Aleanca Libërale e Djathtë” me parti pjesëmarrëse Balli Kombëtar Demokrat, Bashkimi Liberal Demokrat dhe Bashkimi Demokrat për zgjedhjet e 14 majit 2023, me shkronjat nistore ALD.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim Brenda 3 ditëve në KAS.

Vendimi nr. 177

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



18.03.2021
Ora 11:27

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, (BF), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaç, Znj. M. Koja, Znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike:** **PD (I. Sefa) (F. Nuri) PL (A. Kaziaj)**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës. Shqyrtimin e kërkesës së koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Zoti Sekretar.

Z. Y. Merkaç: Katër parti politike kanë paraqitur kërkesë pranë KQZ-së dhe konkretisht Partia e Lirisë, Partia Demokratike e Shqipërisë, Partia Demokristjane dhe Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut, për tu regjistruar si koalicion në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se 3 partitë e para Partia e Lirisë, Partia Demokristjane dhe Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut janë të regjistruara si subjekte zgjedhore në këto zgjedhje ndërsa Partia Demokratike e Shqipërisë nuk është regjistruar si subjekt zgjedhor. Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dokumentacioni, si marrëveshja e koalicionit, emri i koalicionit, shkronjat nistore,

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

partia politike udhëheqëse e koalicionit si edhe personin e autorizuar që do të përfaqësojë koalicionin dhe zevendësin e tij. Bashkëlidhur keni projektvednimin për shqyrtim e miratim, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Zoti Kaziaj, si përfaqësues i autorizuar për të paraqitur kërkesën për regjistrimin e këtij koalicioni.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL-së: Faleminderit zoti Komisioner! Ne kemi paraqitur kërkesën sipas afateve të parashikuara në Kodin Zgjedhor në dt. 15.03.2023, sipas parashikimeve të ligjvënësit në nenin 65, pika 1, 2 dhe 3, kërkesa përmban gjithë elementët e nevojshëm për regjistrimin e koalicionit, siç janë ato të emrit të koalicionit, shkronjave nistore, partive përbërëse ku dy ose më shumë parti thotë ligjvënësi. I jemi drejtuar këtij komisioni dhe sot po marrim në shqyrtim këtë kërkesë. Bashkëlidhur kërkesës keni të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar nga ligji, marrëveshjen për krijimin e koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Po ashtu kemi bashkëlidhur dhe gjithë firmëtarët e kësaj marrëveshje, kryetarët e partive përkatëse, gjithashtu kemi bashkëlidhur të gjitha deklaratimet e bëra nga deputetët që kanë vetëdeklaruar përkatësinë e tyre politike dhe vërtetimin përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Shqipërisë. Për sa më sipër kërkojmë regjistrimin e koalicionit sipas kërkesës së bërë nga ana e koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Unë si përfaqësues i tij në dt. 15.03.2023, kërkoj të merret në shqyrtim dhe të miratohet regjistrimi nga ana juaj, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit zoti Kaziaj! Përfaqësuesi i Partisë Demokratike në KQZ.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po i nderuar zoti Komisioner. Së pari duhet të qartësojmë edhe njëherë faktin që Sekretari i Përgjithshëm me keqardhje konstatoi që nuk është njohur as ai me vendimin e datës 16.03.2023 , nr. 27 i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve ku Partia Demokratike është regjistruar si subjekt zgjedhor. E dyta që është dhe më e rëndësishmja, unë si përfaqësues i përhershëm i Partisë Demokratike në KQZ, ju konfirmoj se Partia Demokratike nuk ka bërë asnjë koalicion. Ju konfirmoj gjithashtu se është përdorur emri, janë përdorur karakteristikat dhe logo e Partisë Demokratike. Neni 65 përcakton qartë nga persona të paautorizuar dhe të palegjitimuar nga ky komision, nga Komisioneri dhe nga igji. Kërkesë e domosdoshme e nenit 65 është depozitimi i marrëveshjes. Komisioneri duhet të konstatjë që kjo marrëveshje është bërë në mashtrim të ligjit dhe në mashtrim të zgjedhësve. Partia Demokratike e Shqipërisë nuk ka asnjë kërkesë për koalicion. Nuk e di kush është subjekti zgjedhor që i është drejtuar dhe kush është personi përgjegjës që i është drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me një kërkesë e cila është në shkelje të ligjit. Komisioneri ka të gjitha detyrimet ligjore për të marrë masa dhe për të marrë të gjitha hapat ligjorë të nevojshëm për të vënë në vend këtë shkelje të dispozitave ligjore. Së dyti, kjo kërkesë duhet rrëzuar, për sa kohë marrëveshja është dokument i domosdoshëm për paraqitjen në KQZ. Kjo marrëveshje nuk është e ligjshme, ndaj kërkojmë nga ana e Komisionerit, në bazë të nenit 65, pika 3, të rrëzojë këtë kërkesë sepse në të është shprehur vullneti për Partinë Demokratike nga persona të paautorizuar. Po jua konfirmoj në mbledhje publike. Partia Demokratike nuk ka bërë asnjë koalicion, aq më pak me Partinë e Lirisë, Partinë Demokristjane dhe PBDNJ-në. Subjektet që pretendojnë se legjitimohen për të firmosur dhe për të nënshkruar akte në emër të Partisë Demokratike janë subjekte që nuk kanë asnjë të drejtë për ta përfaqësuar atë. Kërkoj nga ana e Komisionerit të marrë masa imediate duke

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

rrëzuar kërkesën dhe duke marrë gjithë hapat e tjerë ligjorë për të zgjidhur çështjet në themel.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL-së: I nderuar zoti Komisioner unë mendoj se kolegu Sefa edhe po të ishim në zgjedhje të një shteti fqinj që mund të jetë Mali i Zi ose Maqedonia e Veriut do të shkonte në seancë publike dhe do të jepte kundërshtitë e veta për rrëzimin e kërkesave dhe në Mal të Zi. Këtë nuk e vë në dyshim sepse kjo është çështje karakteri dhe qendrimeve tashmë të njohura botërisht. Ftoj kolegun Sefa të lexojë frymën e ligjit, ligjvënësit, pikërisht në nenin 65, ku thotë dy ose më shumë parti politike, të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, sipas nenit 64.... (nuk dëgjohet) . Tani flet në emër të një partie, të paktën duke marrë tagra të tillë, të një partie që ende nuk është regjistruar në përputhje me pikën e parë të nenit 65. Si mundet ne të dëgjojmë kaq gjatë një koleq që ende partinë e prezumuar nga ai, që është përfaqësuesi i saj, nuk ka ndjekur hapat që ligjvënësi i ka vënë për tu regjisrtuar, aq më keq për të kundërshtuar disa parti politike , të cilat janë regjistruar sipas nenit 64 dhe sot në seancë publike, në formën e një bashkëpunimi të një koalicioni të regjistrohen sipas gjithmonë pikës së parë të nenit 65. Kështu që, i nderuar zoti Komisioner, me shumë respekt për ju personalisht dhe për institucionin që ju përfaqësoni të vazhdojmë më tej me ato që janë vendimmarrja juaj lidhur me kërkesën e bërë bga ana jonë në datën 15.03.2023. Edhe një sqarim tjetër lidhur me një vendimmarrje që zoti Sefa tha se nuk kam qenë i kujdesshëm, paskam pasë punët e mia dhe nuk paskam qenë i vëmendshëm për vendimmarrjen e një organi kolegjal , siç është KAS. Referuar po nga ai, vendimi nr. 27, dt, 16. 03.2023 i këtij komisioni, pika gjashtë e tij thotë, “Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Administrativ brenda 5 ditëve nga shpallja e tij. Pra mendoni ju i nderuar zoti Komisioner se jemi në kohë,

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

që Partia Demokratike e Shqipërisë të bëjë një ankim kundër këtij vendimi? Unë mendoj që po. Dita e hënë është dita e fundit. Kështu që, të lihen afatet e parashikuara nga ligjvënësi dhe mos të bëjmë lojra fjalësh këtu, nëpërmjet një përfaqësuesi të një partie të paregjistruar, i cili ditën e shtunë po na e merr me disa momente shumë të vlefshme nga ana jonë, duke na thënë disa gjëra që nuk qendrojnë as në ligj, as në logjikën më të thjeshtë të një juristi, faleminderit.

Z. F. Nuri: Vetëm një plotësim, meqenëse ende nuk kam folur. Jam plotësiht dakord me kolegun Kaziaj. Së pari përfaqësuesit, zoti Sefa për mendimin tim i mungon legjitimiteti sot për të ndërhyrë në këtë pikë të rendit të ditës. Arsyeja e tha dhe kolegu është që Partia Demokratike ende nuk është regjistruar si subjekt zgjedhor. Sot që flasim, në këtë çast që flasim. Në lidhje me parashtrimet, pretendimet sipas të cilave marrëveshja paska shkelje ligjore apo shkelje të tjera, të natyrave të tjera ne i kundërshtojmë këto gjëra me forcë dhe theksojmë se në datë 15 mars, kur është dorëzuar marrëveshja, ka qenë totalisht në rregull, në respekt të ligjit dhe Kodit Zgjedhor. Ashtu sikurse tha dhe kolegu Kaziaj, ka qenë të paktën siç kërkon kodi 2 i partive e regjistruar në atë moment. Partia Demokratike është ende në proces regjistrimi. Në datën 16 mars, sikurse të gjithë e dimë, KAS-i me një vendim skandaloz mori atë vendimmarrje që mori, por pak rëndësi ka kjo. Ne jemi brenda afateve të ankimit, sot është data 18, kanë kaluar vetëm 2 ditë. Vendimi i KAS-it nuk është akoma i formës së prerë dhe i zbatueshëm për sa kohë ligji lejon që të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor renda 5 ditëve. Ne jemi duke punuar me hartimn e ankimit në Kolegjin Zgjedhor, ndaj në këto kushte kur ende nuk ka një vendim të formës së prerë, të zbatueshëm dhe për më tepër Komisioneri nuk është shprehur akoma, në lidhje me regjistrimin apo jo

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

të Partisë Demokratike, jemi në kushtet kur nuk ka vend fare për këto diskutime, faleminderit.

Z. A. Kaziqaj, përfaqësues i PL-së: Zoti Komisioner edhe një saktësim të fundit, më falni zoti koleg. I sjell në vëmendje kolegut. Ne kuadër të asaj që sapo përfundova të thoja, të shohë dhe pjesën e përkufizimeve që ligjvënësi në mënyrë shumë të qartë ja ka vënë Kodit Zgjedhor. I referohem nenit 2 të ligjit të Kodit Zgjedhor, pikës 20 ku thotë, “Subjektet zgjedhore janë, partitë politike, koalicionet e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit , si dhe kandidatët për kryetar të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë kod”. Tani po bëj një pyetje retorike. Mendoni ju zoti Komisioner se në këtë moment që ne po flasim, domethënë në datën 18 mars, ora 13:39 rezulton e regjistruar partia prezumuar me sigël, me vulë, me emër kryetar partie, me depozitim të deklaratës solemne i kolegut sefa?!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Zoti Sefa fjala për ju.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Së pari zoti Komisioner dhe në respekt të kolegut se nuk kisha dëshirë të merresha personalisht, por do të ju bëj një kërkesë. Ju mos e lini më ditën e shtunë ose të diel se na shqetësohen dhe kolegët. Ta lini ditë jave që mos ti hamë kohë gjatë këtyre 2 ditëve. E dyta, kur lexohet një vendim fillohet nga pika e parë, deri tek pika e gjashtë, nuk kalohet nga e gjashta pastaj tek e para. Pika 5 e vendimit 27 thotë, “ Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të KQZ-së.” Besoj se shqipen e lexoj dhe e kuptoj ashtu siç e lexoj. E dyta , nuk dua të merrem në asnjë rrethanë me interesin e ligjshëm që ka subjekti zgjedhor, Partia e Lirisë për tu marrë me PD-në dhe interesat elektorale që

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

ka për tu marrë me PD-në, por unë i referohem shprehimisht ligjit siç jeni në dijeni ju, besoj duhet të jetë edhe kolegu që unë jam përfaqësues i përhershëm i Partisë Demokratike të Shqipërisë, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. I përhershëm, po jua konfirmoj përsëri. Partia Demokratike nuk ka bërë asnjë marrëveshje për lidhjen e koalicionit zgjedhor dhe nuk ka depozituar asnjë marrëveshje të tillë. Subjektet që kanë folur dhe kanë nënshkruar në emër të Partisë Demokratike, nuk janë subjekte që e përfaqësojnë Partinë Demokratike. Ndaj ju kërkoj që ti referoheni shprehimisht nenit 65 të Kodit Zgjedhor duke e rrëzuar këtë kërkesë, faleminderit.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL-së: Edhe një gjë të fundit. Ju lutem ju sjell në vëmendje atë që sapo tha zoti Sefa, e cila nuk qendron për sa i përket vendimarrjes së marrë nga KAS-i. Ju e dini që nuk mundet ky komision, një pothuajse gjykatë, ndërkohë që ligji lejon një ankim dhe forma e prerë e një vendimi merret nga një Kolegj Zgjedhor. Është ABC-ja e Kodit Zgjedhor. Kush njih mirë Kodin Zgjedhor, njih mirë dhe mënyrat se si ankimohet. Afatet e tij dhe kush, të themi për ta thjeshtëzuar për dëgjuesit, kush vë vulën përfundimtare të një vendimi të paankimueshëm, siç është vendimi i Kolegjit Zgjedhor. Kolegji Zgjedhor ka patur të themi, analogji në vendimarrjen e tij. I referohem vendimit nr. 1, dt. 09.05.2019, në proces zgjedhor të mëparshëm. Ka patur analogji lidhur me vendimarrjen, me përfaqësimin në seancën publike pranë kësaj trupe gjyqësore, e cila merr vendime të formës së prerë lidhur dhe me legjitimitetin e palëve që marrin pjesë në këtë proces. Kështu që vendimi i lexuar nga ana ime, i referuar nga kolegu Sefa që mban nr. 27, dt. 16.03.2023 i KAS-it është i lexuar, në mënyrë, në formë dhe përmbajtje, në gjithçka, pavarësisht referimit të pikës përkatëse që unë referova. Pavarësisht lajthitjes që ka patur domethënë ky

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

komision, të paktën në këndvështrimin tim. Të paktën 4 anëtarët e këtij komisioni, i bënë nder anëtarit të 5-të që ka dalë mendim pakice. Kështu që e kemi shumë të qartë. Le ta vazhdojmë më tej këtë vendimmarrje nga ana juaj në mënyrë që mos të vonohemi me gjëra të kësaj natyre, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Përpara se ti jap fjalën zotit Sefa, do të kërkoja gjithë mirëkuptimin tuaj që ta përfundojmë gjithë argumentin tuaj këtu dhe të vazhdojmë pastaj sipas procedurës. Zoti Sefa fjala është për ju

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Dy fjalë të shkurtra zoti Komisioner. Së pari do i kërkoj ndjesë kolegut që nuk kam marrë një smoking siç e do dhe rasti. E dyta procedura civile bazë e së drejtës dhe parimet bazë të së drejtës, ka dy lloj vendimesh. I formës së prerë dhe i ekzekutueshëm. Po mësove njërin, duhet të hapësh sytë që ka dhe një vendim tjetër që është i ekzekutueshëm. Kështu që i ekzekutueshëm është vendimi kur referohet që është i ekzekutueshëm dhe thotë, “Ky vendim hyn në fuqi menjëherë” dhe është i ekzekutueshëm. Pastaj dispozitat e tjera janë kur merr formë të prerë.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përpara se të vazhdojmë në lidhje me këtë çështje, unë kam një pyetje për zotin Kaziaj si përfaqësuesi, kërkues për regjistrimin e këtij koalicioni. Shikoni arsye dhe nevojë për të bërë plotësime të këtij dokumentacioni?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL-së: I nderuar zoti Komisioner, siç relatova më parë, dokumentacioni i kërkuar nga ana e ligjit, neni 65, dokumentacioni i depozituar nga ana jonë dhe nga ana ime si përfaqësues i koalicionit “Bashkë Fitojmë” është i plotë, është sipas kërkesave të ligjit, në përputhje me nenin e parë, të dytë dhe të

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

tretë të nenit 65, kështu që nuk ka nevojë as për tu riparë, as për tu rishikuar dhe as për tu plotësuar. Kështu që ju ftojme të merrni vendimmarrjen tuaj duke zbatuar ato që janë... që është dhe vet forma dhe fryma e ligjvënësit, faleminderit.

Z. F. Nuri: Faleminderit! Edhe unë në cilësinë e përfaqësuesit të koalicionit bashkohem me kolegun Kaziaj. Nuk kemi asnjë dokument tjetër për të plotësuar. Gjykojmë që çdo gjë është në përputhje me ligjin dhe kërkojmë miratimin e kërkesës nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, faleminderit.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Zoti Komisioner ne kërkojmë rrëzimin e kërkesës si një kërkesë që nuk plotëson dispozitat e nenit 65 të kodit zgjedhor, me një marrëveshje e cila është bërë në mashtrim të ligjit dhe të zgjedhësve dhe nuk përfaqëson vullnetin e Partisë Demokratike për të qenë pjesë apo për tu referuar në të. E dyta, ne mendojmë se Komisioneri do të marrë vendim për rrëzimin e kësaj duke patur në konsideratë dhe vendimmarrje të mëparshme, i cili ka referuar se i referohet germës së ligjit dhe germa është fare e qartë, faleminderit!

Z. I. Celibashi: E sigurtë është që vendimmarrja do të jetë tërësisht në respektim të dispozitave të Kodit Zgjedhor. Mendoj që ne jemi në fakt përpara së njëjtës situatë dhe nuk kemi pse të mos e themi sikurse ishte ajo e prag zgjedhjeve të 6 marsit të vitit 2022, ku pak a shumë ishte e njëjta kërkesë, pak a shumë me të njëjtët subjekte kërkuese për tu regjistruar. Një subjekt zgjedhor, gjithsesi kjo jo për të konfirmuar vazhdimësinë, respektimin dhe precedentët e vendosur nga ky institucion në lidhje me kërkesa të tilla të ngjashme, por më shumë akoma bazuar në atë që në vijim unë po them. Ajo çfarë thotë përfaqësuesi i Partisë Demokratike

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

në lidhje me faktin që Partia Demokratike nuk është pjesë e asnjë koalicioni pa konsideruar faktin...

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL-së: Ju lutem, ju po etiketoni, duke thënë përfaqësuesi i Partisë Demokratike, ndërkohë që ju që jeni përgjegjës për regjistrimin e subjekteve zgjedhore ende nuk e keni regjistruar. Kështu që ju lutem, mund ti referoheni me mbiemër zotit Sefa, por jo si përfaqësues i Partisë Demokratike, për shkak se ju ende nuk e keni regjistruar, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit zoti Kaziaj, për sjelljen në vëmendje të këtij momenti, por sikurse e kam deklaruar dhe herë të tjera publikisht zoti Indrit Sefa përfaqëson Partinë Demokratike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, gjë që natyrisht nuk do të thotë që ka të gjitha tagrat për çdo marrëdhënie apo veprim juridik që Partia Demokratike Kryen, por nëse nuk gaboju prej gati një viti është përfaqësues i Partisë Demokratike dhe për sa kohë nuk ka një dokumentacion që të provojë të kundërtën ai vazhdon të jetë përfaqësuesi i Partisë Demokratike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Në këtë cilësi, si përfaqësues i Partisë Demokratike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, gjë që sikurse thashë nuk nënkupton, për të evituar çdo lloj keqinterpretimi, çdo atribut të mundshëm që Partia Demokratike mund ti japë një të treti për veprime të ndryshme juridike, por këtë e ka dhe duke e marrë si të mirëqenë që ajo që ai deklaron përfaqëson interesin e asaj partie, do të thotë që mungon vullneti i Partisë Demokratike për të qenë pjesëtare e këtij koalicioni. Është ekzaktësisht në fakt i njëjti arsyetim që unë në cilësinë e Komisionerit kam bërë edhe kur kam shqyrtuar kërkesën e një koalicioni me pak a shumë të njëjtat parti politike në shkurt të vitit 2022 kur është paraqitur kërkesa për tu regjistruar si koalicion. Ju bëra pyetje nëse shikoni arsye

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

dhe nevojë për të ndryshuar dokumentacionin që keni paraqitur, bashkëlidhur kërkesës për tu regjistruar si koalicion. Më konfirmuat që ju e konsideroni të plotë atë dokumentacion dhe për këtë arsye nuk shoh shkak për të marrë një vendim të pjesshëm ose proceduralisht të ndërmjetëm për të bërë plotësimin e dokumentacionit. Kështu që në konkluzion dhe në analizë të të gjitha çfarë përmenda vendosim:

1. Të regjistrojmë koalicionin “Bashkë Fitojmë”, por me parti pjesëmarrëse vetëm 3 parti politike, Partia e Lirisë, Partia Demokristjane e Shqipërisë dhe Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, me shkronja nistore të këtij koalicioni, BF.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në KAS.

Faleminderit!

Vendimi nr. 178

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

18.03.2021
Ora 11:52

RENDI I DITËS

Projektvendim “Mbi zbatimin e vendimit nr. 27, datë 16.3.2023, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, për regjistrimin e “Partisë Demokratike” si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja, Znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike:** **PD (I. Sefa) (F.Nuri) PL (A. Kaziaj)**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirë vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në datën 16.03.2023 ka marrë në shqyrtim kërkesat ankimore nr. 32 dhe nr. 33 me kërkues Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga zoti Indrit Sefa dhe Partia Demokratike e Shqipërisë përfaqësuar nga zoti Ledio Nura dhe zoti Franc Nuri. Në përfundim të shqyrtimit administrativ KAS-i vendosi rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 33 të ankuesit Partia Demokratike, e përfaqësuar në seancë nga zoti Ledio Nura dhe zoti Franc Nuri, pranimin e pjesshëm të Kërkesës Ankimore nr. 32 me ankues Partia Demokratike, të përfaqësuar në seancë nga zoti Indrit Sefa. Ankuesja Partia Demokratike, përfaqësuar në seancë nga zoti Indrit Sefa depozitoi në KQZ dokumentacionin shtesë si më poshtë:

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

1. Deklaratën sipas shkronjës b, pikës 2 të nenit 64 të Kodit Zgjedhor.
 2. Të dhenat për nënkryetarin, zotin Enkelejd Alibeaj në cilësinë e kryetarit të komanduar të partisë.
 3. Deklaratën e angazhimit solemn, të nënshkruar nga nënkryetari, zoti Ekelejd Alibeaj në cilësinë e kryetarit të komanduar të partisë.
 4. Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe detyrimin e Komisionerit të regjistrojë subjektin zgjedhor Partia Demokratike me nënkryetarin, zotin Enkelejd Alibeaj në cilësinë e kryetarit të komanduar të partisë.
- Bashkëlidhur keni vendimin e KAS-it dhe është në vlersimin tuaj zbatimi i këtij vendimi, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Po faleminderit zoti Sekretar! Diskutime në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës? Po zoti Sefa.

Z. I . Sefa, përfaqësues i PD-së: Ka folur qartësisht KAS-i kështu që nuk kam çfarë të diskutoj.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Zoti Kaziaj si përfaqësues i Partisë së Lirisë?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL-së: Dhe i koalicionit të saporegjistruar nga ana juaj. Faleminderit që ju mbani një qëndrim , duke vendosur me objektivitet gjithmonë ato që kanë qenë qëndrimet e mëparshme nga ana juaj, duke aplikuar saktë atë që është pjesa e nenit 65. Pavarësisht pranimit pjesërisht të asaj kërkesë, të paktën për atë pjesë që ju e konsideroni të tillë, është në vlerësimin tuaj. Për sa i përketë pikës së tretë të rendit të ditës, për zbatimin e vendimit nr. 27, dt. 16.03.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, ne kishim rezervat tona që ky vendim

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

ti japë Komisionerit veprime detyruese që ligji vet nuk ja ka dhënë këtij komisioni administrativ të përbërë nga 5 zyrtarë të këtij shteti. As Komisioni Rregullator që është Komisioni tjetër në përbërje të KQZ-së, i cili rregullon veprimtarinë e funksionimit të vet Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, këtu i referohem rregullores nr. 3 të përbërë nga Komisioni Rregullator, ku ka detyra të qarta çdo anëtar dhe vendimmarrja e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve lidhur me disponimin që ata bëjnë. Sipas nesh, nuk mund të disponojnë në këtë mënyrë që kanë disponuar. Janë kryekëput në kapërcim të kompetencave që ligji i ka dhënë. Pavarësisht se kanë bërë një shou politik duke u ndarë 4 me 1, i bënë nder siç e thashë edhe njëherë zotit Çefa, mendimi i pakicës. Në arsyetim të tij kemi qendruar duke lexuar në germë dhe në frymë, ka aplikuar totalisht ligjin, gjë të cilën nuk e kanë bërë 4 anëtarët e tjerë të KAS-it. Kështu që do të duhet ta shihni pak , të themi në frymën e ligjit se kompetencat e qarta të këtij komisioni janë të përcaktuara edhe në ligjin zgjedhor , po ashtu edhe në vet rregulloren e funksionimit të këtij komisioni, rregulloren nr. 3 të Komisionit Rregullator, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Po zoti Nuri.

Z. F. Nuri: Atëherë, edhe në seancën zoti Komisioner që u zhvillua në KAS, si përfaqësues i Partisë Demokratike, por dhe me cilësinë e përfaqësuesit të koalicionit “Bashkë Fitojmë” i bashkohem argumentave të kolegut Kaziaj. Ne nuk jemi në kushtet ku pika 3 e rendit të ditës mund të ketë një rrjedhje, po themi mund të ekzekutohet sot dhe mund të zbatohet sot, për sa kohë ne si palë e interesuar nuk na ka kaluar akoma afati 5 ditor për paraqitjen e ankimit në Kolegjin Zgjedhësor. Për sa kohë jemi brenda këtij afati, jemi duke punuar për

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

paraqitjen e ankimit, gjykojmë që për efekt të njohjes së të drejtës së një mbrojtje efektive, nuk mundet sot Komisioneri të regjistrojë sot subjektin Partia Demokratike dhe ne më pas i bie që të ankohe mi kot në Kolegjin Zgjedhor. Pak a shumë kjo është e gjitha. Duhet që Komisioneri, në gjykimin tim ta pezullojë dhe të na japë mundësinë të paraqesim ankim dhe pas vendimi të Kolegjit Zgjedhor të shohim se ç' do të ndodhë me regjistrimin e Partisë Demokratike. Për sa kohë ne jemi palë e interesuar dhe pretendojmë akoma të regjistrojmë Partinë Demokratike si subjekt me kryetar Sali Berishën. Nëqoftëse ju sot merrni vendim për të regjistruar Partinë Demokratike me kryetarin nënkryetar të shpallur nga KAS-i, atëherë mbrojtja efektive që na e garanton dhe kushtetuta, nuk ka më asnjë lloj vlere ligjore, faleminderit.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL-së: Nëse mundem edhe diçka të fundit i nderuar zoti Komisioner.

Z. I. Celibashi: Nëse e keni mirëkuptimin e zotit Sefa sepse ka kërkuar fjalën.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL-së: Mundem Zoti Sefa?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL-së: Faleminderit! Ju vet disponuat me një vendim duke mos regjistruar asnjë nga kërkuesit apo jo? Duke arsyetuar për atë që është, të themi kërkesa e bërë nga zoti Sefa, pretenduar si përfaqësues i një subjekti politik akoma të paregjistruar sepse nuk ishte në përputhje me parashikimet e nenit 64 që mungonin elementë të mjaftueshëm. E kam lexuar me vëmendje vendimin tuaj,

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

elementë të mjaftueshëm që ligjvënësi nuk i ka vënë me patëdrejtë. Flasim për ndryshime të bëra, sidomos në germën e të themi të nenit 64, të pikës 2. Ndryshime të bëra me ligjin 101 të vitit 2020 kur vet ka pasur siç dihet tashmë botërisht një këshill politik për dakordësinë e rënë mbi një deklaratë me shkrim, të nënshkruar nga kryetari i partisë politike që është një angazhim që kryetari merr, një angazhim slemn, e quan ligji, që kryetari merr për refuzimin për të marrë pjesë në praktika të blerjes së votës, marrjes së financimeve apo përfitimeve në kundraligjshmëri të themi të vet procedimeve të ligjit dhe të vet një praktike demokratike sipas rekomandimeve të bëra nga OSBE\ODIHR-i. Tani jemi duke shqyrtuar një vendmarrje të një komisioni ankimues, i cili ka disponuar me vendim, duke ju kushtëzuar dhe duke ju vënë juve në detyrimin për marrjen e një vendmarrje që është kryekëput në kapërcim e jo normalisht në zbatim të parashikimeve që ligjvënësi ka bërë në nenin 64. Veç kësaj, ju e dini shumë mirë që një nga elementët që mungonte ishte vërtetimi i subjektit politik dhe të kryetarit të partisë të dhënë nga gjykata, të paktën për atë që pretendohet nga vendimi nr. 27 i Komisionit të Ankimimeve dhe Saksioneve, që duhet të jetë kryetari i partisë. Ndërkohë që në një dokument të pazëvendësueshëm të gjykatës që mbajnë regjistrat e partive politike që është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, saktësohet në mënyrë të qartë që kryetari i partisë është zoti Lulëzim Basha ndërkohë që Komisioni i ankimimeve dhe Sanksioneve nuk interesohet fare për këtë dokument të pazëvendësueshëm dhe të domosdoshëm, të paktën kështu është në frymën e ligjit. Jo më kot ju nuk e regjistruat as kërkesën e e bërë nga përfaqësuesit e Partisë Demokratike të Shqipërisë, nëpërmjet zotit, kryetarit, zotit Sali Berisha, për mungesë të këtij dokumentacioni. Ndërkohë ky Komision tipik politik me një vendimmarje joprocedurale por politike, nëpërmjet qokave që ka bërë nga 4 anëtarë të këtij komisioni, i janë referuar ligjit sipas mënyrës së interpretimit të

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

paktën për atë që është fryma e ligjvënësit lidhur me këto dokumenta të pazëvendësueshme. Duhet të ishte mbajtur një qendrim paralel, ekuivalent, siç u mbajt të paktën nga ana juaj. Duhet të ishte mbajtur dhe nga ana e tyre. Ju keni zbatuar ligjin, aplikuar ligjin, të themi në njëfarë mënyre. Pavarësisht të themi, pjesëve të vogla të themi, të leximit ndryshe nga ana jonë, por nuk mund të jemi këtu përpara jush me një vendim detyrues që i ka kaluar tagrat e këtij komisioni, që ligji dhe rregullorja vet i ka dhënë dhe debatojmë mbi një atipicitet dhe alogjikshmëri të një vendimi që nuk bazohet në asnjë nga nenet, pikat, dispozitat e Kodit Zgjedhor, apo çdo akti normativ që rregullon atë, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Zoti Sefa.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Përsëri i kërkoj ndjesë kolegut që i hëngra shumë kohë sot, si ditë fundjave, pavarësisht se mbajti një ore e gjysëm referat për Partinë Demokratike dhe unë nuk e kuptoj interesin që ka me Partinë Demokratike, megjithëse jam fare i qartë për cilën arsye e bën. Një gjë doja ti shpjegoja. Lidhet me ABC-në e së drejtës dhe ndarjen e pushteteve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me formulën e re është ndarë në 3 pushtete. Ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor. Ekzekutivi është Komisioneri, legjislativi është Komisioni Rregullator dhe gjyqësori Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve. Nuk ekziston që ekzekutivi mos të zbatojë një vendim të organit gjyqësor që është KAS-i. Por, arsyet politike të ngritura dhe dëshira për të bërë debat shterpë , të kotë dhe politik në këtë institucion nuk i vjen përshtat asnjë përfaqësuesi partie politike. Në lidhje me vendimin e KAS-it dhe ndarjen politike ka të gjitha rrugët dhe mënyrat për tu ankuar, megjithëse në dijeninë time PL-ja apo ish LSI-ja nuk është pjesë e asaj vendimmarjeje kështu që besoj se e mira është ta komentojë publikisht aty jashtë

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

apo në mediat sociale. Ndaj Komisioner mendoj se ligji është i qartë, vendimi është i qartë dhe ju do ta zbatoni atë, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit zoti Sefa! Atëherë nëse diskutime të tjera për këtë pikë të rendit të ditës nuk kemi. Në lidhje me vendimmarrjen pasuese nuk kam shumë për të thënë, vec faktin që ky vendim i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve ngelet thjesht dhe vetëm teknikisht për tu zbatuar nga Komisioneri Shtetëror. Pasi tej çdo lloj diskutimi dhe pikëpamje të gjithsecilit, në fund të fundit është akti i një organi të parashikuar nga ligji, respektivisht nga Kodi Zgjedhor për të vendosur për çështje të tillë dhe për sa kohë ky organ ka vendosur regjistrimin si subjekt zgjedhor të partisë politike “Partia Demokratike”, ngelet thjesht dhe vetëm aplikimi dhe zbatimi i këtij vendimi. Për të mos e zgjatur më tej, vendosim:

1. Regjistrimin, në fakt e ka vendosur KAS, të subjektit zgjedhor “Partia Demokratike” me nënkryetarin zotin Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të partisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare të KQZ-së
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim Brenda 3 ditëve në KAS.

Vendimi nr. 179

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

18.03.2023
Ora 12:06

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Rodolf Llambi Xhillari, me funksion anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë.”

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja, Znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike:** **PD (I. Sefa) (F.Nuri) PL (A. Kaziaj)**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. Y. Merkaj: Në zbatim të nenit 138, të vitit 2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimit të zgjedhjes dhe emërimit për funksionet publike si dhe përpunimin për shumën reale dhe deklarimit për disa subjektet zgjedhore, ndër të cilat dhe anëtari i këshillit bashkiak. Në zbatim të këtyre dispozitave zoti Rodolf Llambi Xhillari, aktualisht (*nuk kuptohet*) në Këshillin e Bashkisë Tiranë. Në datën 9 shtator 2021 ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2180. Nga verifikimi i të dhënave nga formulari i vetëdeklarimit, rezultoi se kandidati nuk ishte në kushtet e mosvlefshmërisë dhe me vendimin nr. 454, datë 23.09.2021 ka njoftuar Këshillin Bashkiak të vijojë procedurat e mëtejshme për dhënien e mandatit. Nga verifikimi i të dhënave të vetëdeklarimit, zoti Rodolf Xhillari rezulton se ka ndryshuar emrin nga Roland në Rodolf dhe mbiemrin nga (*nuk kuptohet*) në Xhillari. Gjithashtu në rubrikën të dhënat

**Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

gjqësore të personit, ka deklaruar se ka marrë masë shtrënguese të sigurisë, arrest me burg, e cila është evokuar. Nga data 15.03.1996 deri në 15.06.1996, Gjykata e Shkallës së parë Athinë e ka akuzuar për veprën penale “Kontrabandë të mallrave në doganën greke” dhe është shpallur i pafajshëm. Në konstatimet e mësipërme bazuar në nenin 8, të ligjit nr.138, të vitit 2015 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur t’ia kalojë rastin për zhvillim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme. Në datën 13.03.2023 Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin, zotin Rodolf Xhillari. Referuar vendimit për miratim të rezultatit të verifikimit, subjekti i vetëdeklaruar, zoti Rodolf Xhillari, anëtar i Këshillit të Bashkisë Tiranë nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të ligjit nr. 138, të vitit 2015. Pra nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit ose të mosvlefshmërisë. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim e miratim, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Mirë atëherë, është e qartë që nuk jemi në kushtet e ndalimit për këtë subjekt. Jemi në kushtet e lejimit të vazhimit të statusit që ka, të mandatit.

Vendimi nr. 180

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

18.03.2023
Ora 12:09

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 100, datë 08.03.2023 “Për caktimin e numrit të kandidatëve në listat shumemërore të paraqitura nga subjektet zgjedhore për çdo zonë zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja, Znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike:** **PD (I. Sefa) (F.Nuri) PL (A. Kaziaj)**
- **Të tjerë:** **Qëndresa Qytetare, KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, “Për një ndryshim në vendimin nr. 100, datë 08.03.2023”.

Z. Y. Merkaj: Me vendimin nr. 100 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka caktuar numrin e mandateve në listave shumemërore, të paraqitura nga subjektet zgjedhore për çdo zonë zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Në lidhjen bashkëlidhur është bërë një gabim në material. Tek Bashkia Kuçovë nga numri 22 i anëtarëve të Këshillit të Bashkisë duhet të jetë 32. Për këtë arsye kërkojmë ndryshmin e vendimit.

Z. I. Celibashi: Në fakt nuk është gabimi jonë por ashtu e kanë sjellë...

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2023*

Z. Y. Merkaj: E ka sjellë Nënprefekti i Qarkut të Beratit.

Z. I. Celibashi: Po, që të bëjmë korigjimin.

Z. Y. Merkaj: Korigjimin për numrin.

Z. I. Celibashi: Mirë, dakord! Çështje të tjera në rend dite nuk kemi. Seanca mbyllet, faleminderit!

Vendimi nr. 181

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

